

**KËSHILLI I PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE
TË QYTETIT TË ZAGREBIT**

S T A T U T I

**I KËSHILLIT TË PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE
TË QYTETIT TË ZAGREBIT**

Zagreb, 7 shkurt 2004

Në bazë të dispozitave të nenit 27 të Ligjit Kushtetues mbi të drejtat e pakicave kombëtare (N.N. 155/02.) Këshilli i pakicës kombëtare shqiptare të qytetit të Zagrebit, në mbledhjen e mbajtur më dt. 7 shkurt 2004 miratoi këtë:

S T A T U T

TË KËSHILLIT TË PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE TË QYTETIT TË ZAGREBIT

I. DIZPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1.

Me këtë statut caktohet:

1. Emri, selia dhe vula e Këshillit të pakicës kombëtare shqiptare të qytetit të Zagrebit
2. Fushëveprimtaria e Këshillit
3. Pozita juridike, përfaqësimi dhe paraqitja
4. Veprimtaritë e Këshillit me të cilat realizohen qëllimet
5. Struktura e Këshillit dhe emri
6. Organet e Këshillit, struktura e tyre, mënyra e zgjedhjes dhe revokimit dhe kushtet të tjera
7. Autorizimet e Këshillit dhe mënyra e vendosjes
8. Kohëzgjatja e mandatit dhe përgjegjësi e anëtarëve të Këshillit
9. Pasuria e Këshillit dhe mënyra e fitimit të pasurisë dhe financimit

10. Aktet e përgjithshme të Këshillit

11. Puna publike

12. Pyetjet të tjera me rëndësi për punën e Këshillit dhe veprimtarinë e tij

NENI 2.

1. Emërtimi i Këshillit është: Vijeće albanske nacionalne manjine Grada Zagreba.
2. Krahas emërtimit në gjuhën kroate, Këshilli emërtohet edhe në gjuhën shqipe: Këshilli i pakicës kombëtare shqiptare të qytetit të Zagrebit
3. Krahas emrit të plotë, Këshilli mund të përdor shkurtimin, e përkrah emrit të Këshillit mund të shënohet stema, flamuri apo ndonjë shenjë
4. Shenja e pakicës kombëtare është shqiponja e zezë dykrerëshe e stilizuar në sipërfaqe të bardhë dhe stema e qytetit të Zagrebit
5. Selia e Këshillit është në Zagreb
6. Këshilli vepron në teritorin e qytetit të Zagrebit
7. Këshillin e përfaqëson kryetari i Këshillit

NENI 3.

Me qëllim të harmonizimit apo afirmimit të intereseve të përbashkëta Këshilli mund të themelojë Koordinacionin e këshillave të pakicave kombëtare ose t'iu bashkangjitet atyre.

NENI 4.

Këshilli e ka vulën e vetë, e cila ka formë të rrumbullakët 35 mm, për

rreth së cilës është i shkruar emri i plotë: Vijeće albanske nacionalne manjine Grada Zagreba dhe Këshilli i pakicës kombëtare shqiptare të Qytetit të Zagrebit, në mes selia në Zagreb e sipas nevojës, adresa, tel. dhe fax.

NENI 5.

Puna e Këshillit është publike, sigurohet dhe realizohet me informimin e vërtetë dhe në kohë të pjestarëve dhe shoqatave të pakicës kombëtare.

Përfaqësuesit e mjeteve publike të informimit mund të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit dhe të informohen lidhur me punën e Këshillit dhe të oganeve të tij.

Me qëllim të realizimit më të plotë të punës publike, Këshilli merr vendim për botimin e gazetës, publikimeve periodike në lidhje me veprimtarinë e Këshillit. Ato shërbejnë për shprehjen e autonomisë kulturore, për zhvillimin, ruajtjen dhe mbrojtjen kulturës dhe traditës.

II. FUSHËVEPRIMTARIA E KËSHILLIT TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË KËSHILLIT

NENI 6.

Qëllimi i Këshillit është mbrojtja dhe afirmimi i intereseve të pjestarëve të pakicave kombëtare në përputhje me dispozitat e Ligjit Kushtetues mbi të drejtat e pakicave kombëtare.

Qëllimet e Këshillit realizohen;

Me propozimet që iu drejtohen organeve të njësive vetëadministrative lidhur me masat që duhet ndërmar për afirmimin e pozitës të pakicës kombëtare në shtet apo në ndonjë fushveprimtari tjetër të saj, duke përfshirë edhe dhënien e propozimeve të akteve të përgjithshme, me të cilat rregullohen çështjet me rëndësi për pakicën kombëtare.

Paraqitjen e kandidatëve për punësim në organet administrative shtetërore dhe organe të njësive vetëadministrative

Me informimin për të gjitha çështjet, të cilat do t'i shqyrtojnë organet e punës së trupit përfaqësues të njësive vetëadministrative dhe kanë të bëjnë me pozitën e pakicës kombëtare.

Qëllimet të tjera të Këshillit do të jenë:

1. Shërbimi në gjuhën amtare, privatisht, publikisht dhe zyrtarisht.
2. Mundësimi i marrjes pjesë në mjetet publike të informimit dhe kryerja e veprimtarisë së informimit publik.
3. Pjesëmarrja e pjestarëve të pakicës në jetën publike.
4. Mbrojtja juridike dhe fizike e Këshillit nga çdo veprimtari, e cila rrezikon egzistencën e Këshillit dhe realizimi i të drejtave dhe lirive.
5. E drejta që shumica e pjesëtarve të pakicës kombëtare t'i festojnë festat e veta, të cilat ndiqen nga mjetet e informimit publik.
6. Mbajtja e lidhjeve me shtetin mëmë dhe popullin e vetë, në lëmin e edukimit, arsimimit, shkencës, kulturës, përmes botimeve të ndryshme dhe veprimtarive humanitare.
7. Afirmimi i kulturës së pjesëtarve të pakicës kombëtare shqiptare, përmes radios dhe televizionit në nivelin shtetëror, regjional dhe lokal, prodhimi dhe emitimi i programeve të dedikuara informimit të pjestarëve të pakicës kombëtare shqiptare në gjuhën amtare dhe programeve të cilat nxisin mbajtjen, zhvillimin dhe shprehjen e kulturës, besimit dhe vetëegzistencën e pakicës kombëtare.
8. Informimi i pjestarëve të pakicës kombëtare shqiptare lidhur me punën dhe strukturën e Këshillit.

NENI 7.

Të drejtat dhe obligimet e anëtarve të Këshillit janë:

1. Të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur në organet e Këshillit,

2. Të jenë të informuar lidhur me punët e Këshillit.
3. Të kontribuojnë në realizimin e veprimtarive të Këshillit.
3. T'i përmbahen dispozitave të këtij Statuti,
4. Të ruajnë dhe ngrenë autoritetin e këtij Këshilli.

III. PUNA E KËSHILLIT

NENI 8.

Organet e punës të Këshillit janë:

1. Kryetari i Këshillit,
2. Zvendësi i kryetarit të Këshillit
3. Komisioni për çështje financiare
4. Komisioni për program e punës
5. Komisioni për çështje statutare

Këshilli me vendim të posaçëm mund të zgjedhë edhe organe të tjera të punës.

Anëtarët e organeve të punës zgjidhen dhe revokohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarve të Këshillit. Votimi mund të zbatohet gojarisht ose në formë të shkruar.

NENI 9.

1. Mbledhjen e Këshillit e konvokon Kryetari i Këshillit, me anë të ftesave me shkrim, 7 ditë para caktimit të mbajtjes së mbledhjes.

2. Ftesa përmban shënimet lidhur me vendin, kohën e mbajtjes së mbledhjes dhe propozimin e rendit të ditës.
3. Bashkangjitur me ftesën dërgohet materiali i përkatës në lidhje me rendin e ditës, dhe nëse janë me rëndësi për përgatitjen e mbledhjes.
4. Anëtari, i cili e ka marrë ftesën për mbledhje, por nuk i përgjigjet asaj, konsiderohet se ftesa është dërguar në rregull, dhe pa marrë parasysh mungesën e tij, Këshilli do të mbaj mbledhjen.
4. Përrjashtohet nga al. 1. e këtij neni, në raste urgjente mbledhja e Këshillit mund të konvokohet në afat më të shkurtër, me kusht që materiali i nevojshëm t'iu shpërndahet anëtarëve në mbledhje.

NENI 10.

- Në mbledhjet e Këshillit dhe të organeve të Këshillit mbahet procesverbali.
- Procesverbali i shkurtër përmban evidencën e anëtarëve prezentë dhe atyre që mungojnë, si dhe konkluzionet dhe vendimet e miratuara, të cilat verifikohen në mbledhjen e ardhshme.
- Procesverbalin e nënshkruajnë Kryetari i Këshillit, ose personi i cili ka udhëhequr mbledhjen dhe proçeverbalisti.

NENI 11.

- Mbledhjet e Këshillit konvokohen sipas nevojës, më së paku një herë në tre muaj.

- Më së paku një e treta e anëtarve të Këshillit ka të drejtë, që me shkrim, të kërkojë nga ana e Kryetarit të Këshillit konvokimin e mbledhjes
- Nëqoftëse kryetari i Këshillit pa arsye nuk dëshiron ta konvokojë mbledhjen e Këshillit, mbledhjen mund ta konvokojnë një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarve të Këshillit. Këta të fundit nëqoftëse vendosin konvokimin e mbledhjes, caktojnë dhe personin, cili në emër të tyre konvokon mbledhjen.
- Vendimi për konvokimin e mbledhjes, nga ana e anëtarve të Këshillit pa tjetër duhet të ketë arsyetim, i cili i bashkangjitet ftesës për mbledhje. Kryetari i Këshillit pa tjetër duhet të informohet për këtë.

NENI 12.

1. Mbledhjen e Këshillit, të konvokuar nga ana e anëtarve të Këshillit e udhëheq kryetari i Këshillit ose zëvendësi i tij, nëse janë prezentë.
2. Në të kundërtën, mbledhjen e udhëheq personi i cili i ka nënshkruar ftesat për mbledhje, ose personi i zgjedhur nga anëtarët e Këshillit me shumicën e votave të të gjithë anëtarve të Këshillit.
3. Këshilli nuk mund të vendos në mënyrë të plotfuqishme nëse nuk janë prezente shumica absolute e numrit të përgjithshëm të anëtarve të Këshillit, dhe këtë në prezencën e Kryetarit apo zëvendësit të tij.
4. Nëse në mbledhje nuk marrin pjesë gjysma e anëtarve, kryetari mund të konvokojë gojarisht mbledhjen e re në afat prej tre ditësh.
5. Statuti, programi i punës, plani financiar dhe llogaria përfundimtare, aprovohen me shumicën të të gjithë anëtarve të Këshillit dhe me prezencën e domosdoshme të kryetarit të Këshillit apo zëvendësit të tij, si dhe me pajtimin e domosdoshëm të kryetarit.

NENI 13.

1. Këshilli sjellë dhe aprovon Statutin, plotësimet, dhe ndryshimet e tij.

2. Këshilli sjellë programin e punës, planin financiar dhe aprovon llogarinë përfundimtare
3. Këshilli gjithashtu vendos lidhur me zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendësit të tij.
4. Këshilli gjithashtu vendos mbi bashkimin me Këshillat e tjera përkatësisht mbi formimin e koordinacioni
5. Këshilli vendos për të gjitha çështet e tjera me rëndësi për punën e tij, të cilat janë caktuar me Statut.
6. Këshilli bashkëpunon me njësinë vetadministrative lokale në regjionin qytetit të Zagrebit dhe ka të drejtë që të informohet nga ajo për të gjitha veprimtaritë me interes për pjestarët e pakicës kombëtare.
7. Këshilli sjell planin financiar dhe llogarinë përfundimtare me propozim të komisionit për qështje financiare.
8. Për të gjitha vendimet e Këshillit është e nevojshme prezenca dhe pëlqimi i kryetarit të Këshillit.

NENI 14.

1. Kryetari i Këshillit siguron punën e rregullt dhe me ligj të Këshillit
2. Kryetari e përfaqëson Këshillin dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit, konvokon mbledhjet dhe propozon rendin e ditës.
3. Kryetari i zbaton vendimet e Këshillit.
4. Kryetari i propozon Këshillit themelimin e marëdhënjes së punës me punonjësin administrativ i cili duhet të zgjidhet me konkurs publik.
5. Kryetari e infomon opinionin për punët e Këshillit dhe të organeve të Këshillit.
6. Kryetari paraqet Këshillit raportin lidhur me punët e veta. Ai i emëron organet e punës, udhëheq pasurinë e Këshillit dhe lidh kontrata për të mirën e Këshillit.

7. Kryetari me aktivitete të ndryshme i përmirëson kushtet e jetës dhe të punës së pjestarëve të pakicës kombëtare shqiptare.
8. Kryetari merr pjesë në marrëveshje të cilat janë me rëndësi për interesin e pakicës në fushën e veprimtarisë së Këshillit dhe jashtë tij, dhe atë gjithnjë në dobi të pakicës kombëtare.
9. Kryetari apo zvendësi i ti mund të shkarkohen nga detyra me propozim të më së paku një të tretës të numrit të përgjithshëm të anëtarve të Këshillit.
10. Kur Këshilli e shkarkon kryetarin, deri me zgjedhjen e kryetarit të ri, punët e kryetarit i ushtron zvendësi i tij.

Për parregullësi eventuale kompetente është Ministrija si dhe Këshillit për pakicat kombëtare, të cilat pa tjetër duhet informuar.

NENI 15.

- Anëtarët e Këshillit detyrat e veta i krejnë në bazë vullnetare sa ma mirë dhe me kujdes.
- Shpenzimet i mbikqyr administratori, i cili me shkrim e informon kryetarin për çdo ndryshim.
- Kryetari vendos për çfarë do të shfrytëzohen mjetet financiare dhe mbi çfarë baze.
- Për furnizim dhe kryerjen e shërbimeve shfrytëzohen mjetet nga pasuria e Këshillit dhe kjo në përputhje me Ligjin mbi furnizimin publik.

NENI 16.

- Këshilli është i obliguar të zgjedh kryetarin e ri, në afat prej 30 ditësh nga dita e shkarkimit të kryetarit të mëparshëm.
- Nëqoftëse Këshilli nuk e zgjedh kryetarin e ri në afatin e caktuar, për situatën do të informohet Këshilli për pakicat kombëtare.

NENI 17.

- Anëtarët e Këshillit nga mjetet e Këshillit mund të marrin vetëm kompenzimin e shpenzimeve për punët e kryera të Këshillit dhe shpërblimin mujor ose për ndonjë afat tjetër, nëqoftëse e lejon mistri kompetent për punët e përgjithshme administrative, i cili përcakton dhe lartësinë e shpërblimit.
- Për punët normale të Këshillit është e nevojshme të angazhohet punonjësi administrativ.

NENI 18.

Pasuria e Këshillit përbëhet nga të ardhurat, të cilat Këshilli i realizon nga:

- donacionet
- dhurimet
- trashëgimnia
- donacionet nga buxheti shtetëror
- donacionet nga buxheti i njësive lokale dhe teritoriale vetëadministrative në rajonin në të cilin Këshilli vepron
- mjetet e fituara nga organizatat ndërkombëtare të cilat e përkrahin punën e Këshillit
- të ardhura tjera sipas ligjit mbi bashkësitë (sponsorimi).

Mjetet financiare mund të shfrytëzohen vetëm për veprimtaritë dhe punët me rëndësi për pakicën kombëtare dhe punët e Këshillit, të cilat janë të caktuara në programin e punës së Këshillit të pakicës kombëtare

NENI 19,

- Këshilli e qeveris pasurinë në përputhje me dispozitat mbi veprimtarinë materiale dhe financiare të organizatave jofitimprurëse.
- Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet caktohen me planin financiar, i cili aprovohet për vitin kalendarik dhe vlen për vitin për të cilin është aprovuar.
- Në përfundim të vitit, për të cilin është aprovuar plani financiar, përpilohet bilanci financiar, si dhe në rastin kur ndërrohet kryetari.
- Kryetari i Këshillit ka të drejtë urdhërdhënëse për disponimin e pasurisë së Këshillit, dhe këtë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

IV. STATUTI DHE AKTET TJERA TË PËRGJITHSHME

NENI 20.

- Statuti është akt i përgjithshëm themelor i Këshillit dhe të gjitha aktet e tjera duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Statutit.
- Interpretimin e dispozitave të Statutit e bën Këshilli.
- Të gjitha ato pyetje të cilat nuk janë rregulluar me këtë Statut, mund të rregullohen me Rregulloren e punës.

NENI 21.

- Statuti, plani financiar dhe bilanci financiar i Këshillit shpallen në gazetën zyrtare të qytetit të Zagrebit.
- Statuti hyn në fuqi 8 ditë nga dita e shpalljes në gazetën zyrtare të qytetit të Zagrebit.

Kryetar i Këshillit
Luigj Daka dr.med, v.r.

Zagreb, 7 shkurt 2004.